

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“JAZAJ MARKETING” SHPK**

Sot, më 23 / 12 /2022, Une i nënshkruari:

- Edmond Jazaj, lindur në Kote, Shqipëri më 07.02.1974, mbajtës i dokumentit identifikues “letërnjoftim” me Nr. Personal H40207082J, shtetas shqiptar banues në adresën: *Lagjia Partizani, Rruga Tartar Memushi, Banesa Nr. 111, Vlorë, Shqipëri.*

Me vullnetin tim të lirë dhe në përputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqeritë Tregtare“ (Ligji i Shoqërive) kam vendosur të krijoj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “JAZAJ MARKETING” SHPK. (“Shoqëria”) duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

**Neni 1**

**Emri dhe forma ligjore**

1.1 Emri i shoqërisë do të jetë “JAZAJ MARKETING”, ndjekur ne menyre te pandashme nga shkurtimi “shpk”, cili përfaqëson formën ligjore të saj.

1.2 Shoqëria është një entitet ligjor shqiptar, dhe ka formen ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në pajtim me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare“, i ndryshuar.

**Neni 2**

**Selia dhe kohezgjatja**

2.1 Selia e Shoqerise ndodhet në adresën: ` *Lagjia Partizani, Rruga Tartar Memushi, Banesa Nr. 111, Vlorë, Shqipëri* `.

2.2 Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në nje qytet tjetër të Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2.2 Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 3**

**Objekti i veprimtarisë**

3.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:



*“Shitje-blerje, dhënie me qira ditore apo mujore të automjeteve. Import-eksport automjesh, organizim eventesh, reklamime dhe ndërmjetësime. Tregti brenda dhe jashtë vendit, import-eksport aksesorësh dhe pjesësh këmbimi për automjetet.”*

#### **Neni 4**

##### **Kapitali fillestar dhe ndarja e tij**

4.1 Kapitali i Shoqërisë do të jetë në total 300000 (treqind mijë) Lekë, 1 (një) kuotë, me një vlerë nominale prej 300000 (treqind mijë) Lekë.

4.2 Ortaku themelues Shoqërisë dhe kuotat e zotëruara prej tij në Shoqëri janë si më poshtë:

- (i) Edmond Jazaj, lindur në Kote, Shqipëri më 07.02.1974, mbajtës i dokumentit identifikues “letërnjoftim” me Nr. Personal H40207082J, shtetas shqiptar banues në adresën: *Lagjia Partizani, Rruga Tartar Memushi, Banesa Nr. 111, Vlorë, Shqipëri* i cili zotëron 1 (një) kuotë me vlerë totale 300000 (treqind mijë) lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 5**

##### **Transferimi i kapitalit**

5.1 Kuotat transferohen sipas parashikimeve të Statutit.

#### **Neni 6**

##### **Organet drejtuese dhe Administrimi**

6.1 Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga Administratori dhe organet e saj janë si më poshtë:

- a. Asambleja e Ortakëve
- b. Administratori

6.2 Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve dhe të Administratorit do të përcaktohen në Statutin e shoqërisë.

6.3 Administratori i Shoqërisë do të jetë:

- (i) Z. Edmond Jazaj lindur në Kote, Shqipëri më 07.02.1974, mbajtës i dokumentit identifikues “letërnjoftim” me Nr. Personal H40207082J, shtetas shqiptar banues në adresën: *Lagjia Partizani, Rruga Tartar Memushi, Banesa Nr. 111, Vlorë, Shqipëri* i cili zotëron 1 (një) kuotë me vlerë totale 300000 (treqind mijë) lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## **Neni 7**

### **Gjuha**

7.1 Ky Akt Themelimi hartohet ne gjuhen shqipe nga 3 (tre) kopje secila.

## **Neni 8**

### **Te tjera**

8.1 Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë Akt Themelimi, do të rregullohet nga dispozitat e Statutit të Shoqërisë, ligjit "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

8.2 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

8.3 Ky Akt Themelimi hartohet dhe nënshkruhet nga Ortaku i Shoqërisë, sot më datë 23 / 12 / 2022

**ORTAKU I VETËMI**

**JAZAJ MARKETING SHPK**

**EDMOND JAZAJ**

